E hënë, 26 shkurt 2024
[Seancë e hapur]
[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]
[I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes videolidhjes]
--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Vërej se me përjashtim të z. Krasniqi, i cili ka hequr dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm dhe merr pjesë përmes videolidhjes, të akuzuarit  e tjerë janë të pranishëm në sallë sot.

Do të fillojmë të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit me numër W02749.

Znj. Asistente e sallës, shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.

Asistentja e sallës do t’ju japë tani tekstin e

deklaratës solemne të cilën duhet ta mbani në përputhje me rregullës 141(2) e rregullores. Ju lutem lexojeni.

DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetës dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W2749

[Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar. Mund të uleni.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

Dëshmitar, sot do të fillojmë dëshminë tuaj, e cila pritet të zgjasë afërsisht një ditë.

Siç mund ta dini, Prokuroria do t'ju bëjë e para pyetje. Mbrojtësi i Viktimave nuk do t'ju bëjë pyetje. Kështu që, më të  mbaruar Prokuroria, kanë të drejtë Ekipet e Mbrojtjes t'ju bëjnë pyetje edhe mund të kenë pyetje edhe anëtarët e Trupit Gjykues.

Prokuroria mendon se pyetjet e saj mund të zgjasin një orë e gjysëm. Ndërsa për Mbrojtjen 4 orë. Shpresojmë që përfaqësuesit e ekipeve të ndryshme do të jenë të shpejtë në pyetjet e tyre.

Dhe Trupi Gjykues, në bazë të kësaj, mund të lejojë edhe

bërjen e pyetje plotësuese.

Dëshmitar, përpiquni qartë dhe me përgjigje të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni pyetjen, lirisht mund të kërkoni që t'ju përsëritet pyetja dhe mund të thoni se nuk e kuptoni pyetjen dhe mund t'ua sqarojmë.

Ju lutem, na tregoni edhe se nga i dini faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëhen pyetje. Nëse ZPS-ja ju kërkon që të bëni disa korrigjime a të vërtetoni disa korrigjime të bëra gjatë deklaratave tuaja, ju rikujtojmë që të përmendni që deklarata me shkrim është korrigjuar në përputhje me deklaratën tuaj.

Flisni afër mikrofonit, prisni pesë sekonda në fund të pyetjes, flisni ngadalë në mënyrë që përkthyesit t'ju ndjekin.

Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në këtë sallë gjyqi, nuk ju lejohet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj jashtë sallës së gjyqit. Nëse dikush ju pyet lidhur me dëshminë tuaj jashtë kësaj salle gjyqi, ju lutem na informoni për këtë.

Mos flisni më kur t'jua kërkoj që të mos flisni më apo kur të ngre dorën. Kjo do të thotë se kam nevojë që t'ju jap një udhëzim.

Nëse keni nevojë për pushim, ju lutem na e bëni me dije këtë dhe do t'ua përmbushim dëshirën.

Do të bëjmë një pushim në orën 10.00, përafërsisht 10 minuta.

Tani dëshmia juaj do të fillojë me pyetjet që do t'ju bëjë Prokuroria.

Znj. Prokurore, keni fjalën.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Kryetar, të nderuar Gjykatës. Sot kemi dhe një anëtar të ri të ekipit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të vazhdoni.

Pyetje nga znj. Clanton:

ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

PY. Mirëdita, Dëshmitar. Më quajnë Sarah Clanton. Jemi takuar më përpara. Jam përfaqësuese e Prokurorisë dhe do t'ju bëj pyetje sot.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem, na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem Sekretares të nxjerrë në ekran numrin SITF00255061 deri në SITF00255068. Përkthimi në anglisht ka të njëjtin numër me shtesën në fund -ET Revised. Nuk duhet të jetë për transmetim publik.

PY. Dëshmitar, e njihni këtë që kjo është deklarata që ju keni dhënë?
PË. Po.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem Sekretares të na kalojë në faqen e fundit të deklaratës në gjuhën origjinale dhe të na shfaqë fundin e faqes.

PY. Z. Dëshmitar, e njihni nënshkrimin në këtë faqe?
PË. Po.
PY. Është nënshkrimi juaj?
PË. Po.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem, Sekretares të na nxjerrë dokumentin ne ERN 030943 deri në CR30946 RED2.

Përkthimi është në të njëjtin numër ERN me shtojcën -ET RED. Edhe kjo nuk është për transmetim.

PY. Dëshmitar, ju lutem mos jepni asnjë përshkrim për këtë dokument. Thjesht dua t'ju pyes: A e pranoni që ky dokument ka lidhje me takimin ku keni qenë i pranishëm?

PË. Po.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Sekretares i lutem të na nxjerrë dokumentin me numër 070990-TR-ET Pjesa 2, faqja 1.

PY. Dëshmitar, dokumenti që kemi nxjerrë ka lidhje me një takim me Zyrën e Prokurorit në vitin 2016 [korrigjim i përkthyesit 2019, jo 2016]. Ju kujtohet që jeni takuar me Prokurorinë në vitin 2019?

PË. Po.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ju lutem, nëse mund të nxirrni në ekran tani dokumentin me numër 072709-TR-AT Pjesa 1, faqja 1.

PY. Dëshmitar, dokumenti që kemi nxjerrë në ekran ka lidhje me një takim tjetër që ju keni pasur me Prokurorinë në vitin 2021. Ju kujtohet që keni bërë dhe këtë takim me Prokurorinë në vitin 2021, pak kohë pas intervistës së vitit 2019 [Korrigjim i përkthyesit 2020 dhe jo 2021] pra, në vitin 2020, pak kohë pas intervistës në vitin 2019?

PË. Po.

PY. Dëshmitar, a ju kujtohet se javën që shkoi i keni lexuar këto katër deklarata në gjuhën tuaj?

PË. Po.

PY. A ju kujtohet se keni identifikuar disa korrigjime dhe sqarime në këto deklarata?

PË. Po.

PY. A ju kujtohet se këto korrigjime dhe sqarime janë shkruar dhe ju janë lexuar në gjuhën tuaj?

PË. Po.

PY. Dëshmitar, nëse përfshijmë të gjitha korrigjimet dhe sqarimet që i keni bërë javën që shkoi, informacioni në të katër deklaratat janë të sakta dhe të vërteta me aq sa dini dhe besoni ju?

PË. Absolutisht, po.

PY. Dhe me korrigjimet dhe sqarimet që ju i keni bërë javën që shkoi, katër deklaratat a pasqyrojnë saktë atë që do të thoshit sot po t’ju bëheshin të njëjtat pyetje për të njëjtat ngjarje?

PË. Po.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë pranimin e deklaratave të mëparshme dhe provat materiale të lidhura me to për këtë dëshmitar. Këto janë të gjitha në listën tonë të materialeve. Numrat e ERN jepen në vendimin sipas rregullës 154 me numër F02044. Ka një ndryshim të vetëm nga vendimi i rregullës 154 që ka të bëjë me transkriptin në gjuhën serbe, i cili është vendosur në dispozicion. Numri i ERN së këtij transkripti të rishikuar është 070990-TR-ST Pjesa

3 e Rishikuar. Ne kërkojmë që të pranohen në provat gjyqësore materialet e lidhura dhe Shënimi Përgatitor numër 1.

Është e nevojshme që t'jua lexoj të gjithë numrat e provave?

Z. MISETIC: [Përkthim] Me përjashtim të kundërshtimeve që ne i kemi bërë tashmë sipas rregullës 154, kërkesës së rregullës 154, nuk ka kundërshtime të tjera.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po nga Mbrojtja e Veselit?

Z. TULLY: [Përkthim] E njëjta gjë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Asgjë nga Mbrojtja e Selimit dhe nga Mbrojtja e Krasniqit.

Atëhere materialet me numër SITF0025561 deri në SITF00255068 plus përkthimin në anglisht me numër ERN 0303943 deri në 0303946 RED2, plus përkthimi përkatës, materiali tjetër 072709-TR-ET Pjesa 1, faqja 1, pranohen të gjitha.

070990-TR-ST Pjesa 3 e Rishikuar edhe këtë pranoni që të pranohet në provat gjyqësore?

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohen. Plus materialet shoqëruese dhe pjesa 1 e shënimeve përgatitore.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Për procesverbalin, Shënimi Përgatitor ka numër 119196 deri në 119204. Dhe, mbase ju kam dëgjuar gabim, por dua që të sqarojmë që të gjitha pjesët e

intervistave dhënë ZPS-së i kërkojmë që të pranohen në prova gjyqësore. Pra, për vitin 2019, është Pjesa 2 dhe 3 dhe për vitin 2020, është Pjesa 1 dhe 2.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem mund t'u caktoni numrat.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për deklaratën e parë me numër SITF00255061 deri në SITF00255068, si në anglishte, shqipe dhe serbishte marrin numrin e provës materiale P1021.

Deklarata e dytë, 0303943 deri në 0303946 RED2, së bashku me versionet në shqip dhe në serbisht, marrin numrin e provës materiale P1022.

Deklarata e tretë, 070990-TR-ET Pjesa 2 dhe versioni shqip dhe serbisht, marrin numrin e provës materiale P1023.1. Materiali me numrin 070990-TR-ET Pjesa 3, që është Pjesa 2, do të marrë numrin e provës materiale P1023.2.

Dhe deklarata e katërt, 072709-TR-et Pjesa 1 RED2, së bashku me versionet shqip dhe serbisht, do të marrin numrin e provës materiale P1024.1. Pjesa e dytë e kësaj, me numër 072709-TR-ST Pjesa 2 RED, së bashku versionin në shqip dhe anglisht, do të marrin numrin e provës materiale P1024.2.

Dhe provat materiale përkatëse që e shoqërojnë këto, të nderuar Gjykatës, siç janë të renditura në poshtëshënimin 73 të parashtrim të protokolluar 2044. E para që është me numër 072697 deri në 072708 do të jetë prova materiale me numër

P1025. Materiali i dytë i lidhur, faqet që janë pranuar nëpërmjet poshtëshënimit nga ERN 070982 deri në 070988, faqet 070982 deri 070983 dhe 070987 deri në 070988, do të marrin numrin e provës materiale P1026.

Dhe e fundit, të nderuar Gjykatës, është shënimi përgatitor me numër 119196 deri në 119204, që do jetë prova materiale me numër P1027.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të vazhdoni, e nderuar Gjykatëse [Sipas përkthimit].

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Nëse mund të lexoj përmbledhjen.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta lexoni.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Dëshmitari me numër W02749 ka qenë banor i Prizrenit. Në qershor 1999 është rrëmbyer, rrahur nga anëtarët e UÇK-së. Është shpënë në një ndërtesë të përdorur nga UÇK-ja ku është marrë në pyetje dhe është rrahur më tej.

Gjatë ndalimit, ai ka vërejtur edhe persona të tjerë të ndaluar. Dhe është liruar nga një ushtar i UÇK-së.

Këtu mbyllet kjo përmbledhje.

PY. Dëshmitar, kam një numër të kufizuar pyetjesh të tjera shtesë. Ju lutem mbani mend që Gjykatësit i kanë pranuar në provat gjyqësore deklaratat tuaj, kështu që s’është e nevojshme të jepni shpjegime të gjata.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem Sekretares, që të

nxjerrë në ekran një nga materialet shoqëruese, që sapo është pranuar në prova gjyqësore, me numër P1026 dhe të kaloni ju lutem në faqen 070986.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për procesverbalin, kjo faqe nuk është përfshirë si pjesë e provës materiale 1026.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Vazhdojmë të jemi në seancë publike, Dëshmitar. Pyetja ime është kjo: A e njihni këtë skicë që e keni bërë ju gjatë një interviste të mëparshme?

PË. Po.

PY. E njihni nënshkrimin tuaj në këtë dokument?

PË. Po.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I nderuar Kryetar, siç e bëri të ditur Sekretarja, për shkak të një gabimi tipografik nga ana jonë, nuk është pranuar kjo. Mbrojtja ka bërë të ditur në përgjigjen e tyre të përbashkët sipas rregullës 154, që nuk kanë kundërshtim për këtë dokument. Është diskutuat gjatë një interviste në P01023.1, faqe 32 deri 36. Është një provë materiale që përbën pjesë të pandashme të intervistës dhe ndihmon në sqarimin e intervistës.

Duke pasur parasysh natyrën e dokumentit dhe mungesën e kundërshtimit dhe përgjigjen sipas rregullës 154, kërkoj që të pranohet edhe kjo.

PËRKTHYESI: Avokatët, nuk kemi kundërshtim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

Duke qenë se nuk ka kundërshtime, 070986, kjo faqe pra, me këtë numër do të pranohet në prova gjyqësore.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Nëse nuk ka problem, do t'ia shtoj këtë faqe provës gjyqësore, që tashmë ka marrë numrin P1026.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të rikthehemi në seancë private për mbrojtjen e dëshmitarit, znj. Sekretare.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të bëjmë një pushim prej dhjetë minutash.

--- Seanca ndërpritet në orën 10.02

--- Seanca rifillon në orën 10.12

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, silleni dëshmitarin ju lutem.

Keni ndërmend të vazhdoni në seancë të mbyllur?

Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Punonjëse, të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

Z. MISETIC: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, ju përshkruat situatën në Prizren si kaotike, kështu?

PË. Për cilën kohë e keni fjalën?

PË. Përpara sesa të vazhdojmë, dua t'ju paralajmërojmë se jemi në seancë publike, mos thoni ndonjë gjë që mund t'ju identifikoj.

Në mesin e qershorit të 1999, situatën e keni përshkruar në Prizren si kaotike, kështu ka qenë.

PË. Kaotike ishte që nga çasti kur hyri KFOR-i në qytet dhe forcat ushtarake të Serbisë u larguan nga Kosova. Dhe gjatë kohës që KFOR-i u vendos aty kishte eufori, festime nëpër rrugë. Njerëzit dilnin nga shtëpitë. Qëllonin me armë. Ushtarët e UÇK-së vinin vërdallë në qytet nëpër makina duke shtënë me armë. Pra, kishte kremtime, nga ana tjetër njerëzit e etniteteve të tjera ishin të mbyllur në shtëpitë e tyre dhe nuk e dinin se çdo të ndodhte me ta. Pra, ishte vërtet një

kaos.

PY. Pra, aty ishin civilë, ushtarakë e tjerat, në këtë skenë kaotike të themi?

PË. Kishte ushtarë në për rrugë, civilë po ashtu. Disa kremtonin hyrjen e KFOR-it dhe mbërritjen e UÇK-së, ndërsa serbët rrinin të kyçur në shtëpi me frikën se çfarë do të ndodhte se mos merrnin hak ndaj tyre e kështu me radhë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private, ju lutem.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kthehemi në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

jemi në seancë publike.

Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, për t'ju dhënë një ide për kohën. Besoj se do më duhen edhe 15 minuta pas pushimit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

Z. TULLY: [Përkthim] 10 apo 15 minuta.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit të gjithëve. Do të rishihemi pas gjysëm ore.

--- Pauza fillon në orën 11.01

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi informuar se Dëshmitari 4878 nuk do të jetë në gjendje të dëshmojë sot, sigurisht për këtë nuk e ka fajin askush. Kështu që i lutem Prokurorisë që në sallë të gjyqit të -- dikush nga Prokuroria të takohet me -- të na informojë për këtë mbasi të takoheni me dëshmitarin.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Dua t'ju, dua të sqaroj që bëhet fjalë për Dëshmitarin 3878 dhe jo 4787 [Sipas përkthimit].

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, keni të drejtë.

Atëherë, deri në orën 13.00, pra deri para se të fillojë pushimi, do të kemi një ide se cili është plani. Sigurisht duhet të diskutojmë, mendoj, dhe ato që na kanë mbetur pa

trajtuar lidhur me planifikimin, lidhur me ato që kemi diskutuar javën që shkoi, në mënyrë që të fillojmë të bëjmë plane secila palë dhe secili ekip.

Kështu që pas pushimit të drekës sot do ta bëjmë këtë gjë. Nuk do të zgjasë shumë, besoj se do ta mbyllim brenda orarit të ditës.

Znj. Asistente e Sallës, ju lutem, shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, ju lutem të kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

[Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Këtu bëjmë ndërprerjen e seancës.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.03

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pikë së pari dëshmitari me numër 3878 do të shtyhet derisa të marrim njoftim për disponibilitetin e tij.

Dëshmitari tjetër i radhës do të dëshmojë përmes videolidhjes të mërkurën në mëngjes, por duhet ta përfundojmë brenda të mërkurës. Kështu që të gjithë planifikojeni kohën në përputhje me këtë.

Ne kemi folur me Zyrën Administrative dhe me NJMGJ-në NJAGJ-në, më falni, dhe sa i takon disponibilitetit të sallës,

do të bëj disa ndryshime në mënyrë që të mos humbasim shumë ditë të enjte, po të shikoni dhe kalendarin. Kështu që ata kanë shtuar disa ditë dhe do t’i shikojmë bashkë në mënyrë që t’i shkruani nëse keni një kopje të kalendarit mund ta nxirrni që ta shihni.

Por në thelb në shkurt, mars dhe prill nuk ka asnjë ndryshim. Por në maj mund të shtojmë dy ditë, mbase dhe tre. Me siguri datën 24 dhe datën 30 maj dhe mbase dhe 10 maj. Për datën 10 ende nuk e dimë me siguri. Do të na duhet ta konfirmojmë.

Nuk ka ndryshime në qershor, po në korrik propozojmë të shtojmë një javë tjetër aty ku kemi një boshllëk prej dy javësh, mu përpara pushimit veror. Pra, do të takoheshim katër javë radhë në mënyrë që të plotësojmë kështu dhe atë, që të plotësojmë dhe ditën e mbetura, pra, 15 dhe 18 majin.

Pauza tjetër, tetori dhe nëntori, mund të marrim nga një ditë: 31 tetori dhe 28 nëntori.

Në mënyrë që kështu të mund të kemi kohë në dispozicion për një numër të konsiderueshëm dëshmitarësh.

Dua që të vërej që z. Krasniqi, z. Thaçi dhe z. Selimi janë të pranishëm këtu në, janë të pranishëm në sallë, ndërsa z., ndërsa --

Z. MISETIC: [Përkthim] Desha të bëj një korrigjim.

Z. Thaçi dhe z. Selimi nuk janë në sallë të gjyqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Desha të them

që janë, që na ndjekin me videolidhje.

Ka ndonjë çështje tjetër?

Z. HALLING: [Përkthim] Jo, asgjë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Nëse mundet, lidhur me 15 deri 18 majin, a jo, është për korrikun, po.

Mu përpara pushimit. Desha që të sqaroj. Desha të kuptohemi në parim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e vështirë që të gjenden ditë dhe t'i shtojmë dhe e falënderoj shumë Zyrën Administrative dhe Njësinë e Administrimit Gjyqësor për fleksibilitetin, sepse mirëmbajtja e gjykatës është një detyrë e madhe dhe e cila bëhet vazhdimisht në mënyrë që procesi të zhvillohet sa më normalisht.

Gjithashtu do donim të dinim nga ZPS-ja listën e dëshmitarëve të ardhshëm; ta dorëzojnë këtë listë brenda fundit të javës.

Z. HALLING: [Përkthim] Përditësimi që kemi për bllokun që fillon më datën 18 mars hë për hë. Besoj se e kemi komunikuar një pjesë të kësaj tashmë, por 4811, 2475, 4147 dhe 4739.

1140 është dëshmitar rezervë i cili është sjellë për këtë të mërkurë dhe synojmë ta zëvendësojmë vendin e tij me një apo më shumë dëshmitarë të tjerë që do t'jua njoftojmë sa më shpejt. 3878 do të jetë njëri prej tyre.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, keni fjalën.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Halling, për të qenë të sigurt, urdhri që ju, renditja, më falni, renditja e dëshmitarëve, lista është ajo që keni dhënë dhe më përpara lidhur me thirrjen e dëshmitarëve. Pra, do jetë kjo renditje sa i takon thirrjes së dëshmitarëve?

Z. HALLING: [Përkthim] Fillimisht ka një mundësi që të fillojmë me 01140. Megjithatë do shikojmë se cila është renditja përveç kësaj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dua që të shikojmë të gjithë në natyrë një urdhër gojarisht përpara se të marrim urdhër gojarisht. Do ta lexoj.

Më 21 shkurt 2024 u mbajt një Konferencë për Ecurinë e Çështjes për të parë cilat janë mënyrat për të shpejtuar procesin. Trupi Gjykues mori sugjerime të dobishme nga palët. Trupi Gjykues ka nxjerrë një sërë sugjerimesh të cilat do t’i zbatojë me qëllim që të, në mënyrë që ky proces të vijojë pa vonesa dhe në mënyrën më efektive.

Fillimisht Trupi Gjykues do të qarkullojë një kalendar të rishikuar të cilën do ta bëjmë pasi të kemi dëgjuar nga të gjithë. Besoj se është vetëm ekipi i z. Veseli, ekipi i Mbrojtjes të z. Veseli ai që ka mbetur se të gjithë -- ndërsa të tjerët nuk kanë komentuar. Ekipet e tjera nuk kanë komentuar. Siç e thashë, ne do të jemi në gjendje që të shtojmë edhe tetë ditë të tjera shtesë në këtë periudhë që mbaron deri në nëntor [Sipas përkthimit].

Trupi Gjykues falënderon Zyrën Administrative për ndihmën e dhënë në këtë aspekt.

Së dyti, Trupi Gjykues do të ndryshojë orarin e seancave, të paktën deri në verë që është për seancën e fundit do të zhvillojmë seancë nga ora 13.30 deri në 16.30, është vetëm 30 minuta, por shton diçka.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] 14.30 deri në 16.30.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thashë 13.30? Jo, 14.30; 14.30 deri në 16.30. Pra, është një seancë prej dy orësh pas drekës.

Së treti, Trupi Gjykues ka shqyrtuar, ka bërë një rishqyrtim të çmuar [E pakuptueshme] që bëjnë palët për të bërë kundërpyetje. Këto duken se janë të tepërta. Duhet të them faktikisht në këtë rast se ka sasi të tepruara edhe nga ana e Prokurorisë që kanë të bëjnë kryesisht me dëshmitarë të rregullës 154.

Pas një shqyrtimi që kemi bërë ne duket se përmes shkurtimit të atyre që neve na duket si pyetje të tepërta mund të kursejmë 30 orë vetëm me këta shtatë dëshmitarë; mund të kishin kursyer 30 orë.

Ju lutemi edhe një herë që të bëni një rivlerësim të kohës me shumë vëmendje në mënyrë që të kemi mundësi t'i japim mundësi Mbrojtjes që të zvogëlojë edhe vetë kohën e vet që bën pyetje. Nëse ekipet e Mbrojtjes nuk na japin çmuarje të kundërpyetjeve që të përputhen me këto udhëzime të Trupit

Gjykues, Trupi Gjykues rezervon të drejtën që ta bëjë vetë këtë gjë.

Dëshmitarët të cilët kanë lidhje me këtë që po them janë 4741, 2475, 4811, 1453, 2144 dhe 4147 dhe në fund 4651.

Ekipet e Mbrojtjes urdhërojnë që të ofrojnë çmuarje të përbashkëta për kundërpyetjet jo më vonë se 18 marsi 2024.

E katërta. Kemi një kërkesë për një për të marrë udhëzime nga Trupi Gjykues për një mocion lidhur me faktet e gjykuara. Trupi Gjykues në fakt kërkon sqarime të mëtejshme nga ZPS-ja lidhur me një mocion të tillë. Nëse miratohet kjo atëherë kjo do të kishte ndikim dhe te numri i dëshmitarëve.

Së pesti. Siç është sugjeruar nga palët ZPS-ja dhe ekipet e Mbrojtjes duhet të angazhohen në diskutime *inter partes* mes tyre për të identifikuar më tej pikat për të cilat palët pajtohen apo nuk pajtohen lidhur me pretendimet e, pra, me akuzat që ngrihen në këtë çështje.

Së gjashti. Trupi Gjykues i kërkon ZPS-së që të mendojë dorëzimin e të gjitha ose një pjesë të kërkesave sipas rregullës 153.

Dhe në fund, së shtati, Trupi Gjykues i kërkon ZPS-së që të mendojë dorëzimin e mocioneve të tjera shtesë lidhur me pranimin e provave jo përmes dëshmive gojore.

Kështu që këto ishin pak a shumë pikat që ne po mbajmë parasysh. E di që janë shumë, por nuk e di, ju lutem Prokurorisë të thonë mendimin e tyre.

Z. HALLING: [Përkthim] Po në përgjithësi pajtohem me këto urdhra gojarisht. Mbase sa i takon kohës shtesë në orar dhe kundërpyetjeve janë të dobishme.

Një gjë që nuk është problem por për t'ju dhënë një njoftim disa prej vendimeve tona sipas rregullës 153 janë me njëfarë kushti. Varet se si do të dëshmojnë dëshmitarët gjatë këtij viti. Pra, nuk mund t'i përfshijë në një mocion të vetëm brenda muajit, sepse mund të ketë zhvillime të tjera. Por nuk kemi ndonjë kundërshtim për këtë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë e kuptojmë por shikoni çfarë mund të bëni hë për hë, pra, në mënyrë që të përfshijmë edhe një mocion të tillë sa më shumë të jetë e mundur, duke pasur parasysh edhe ata të cilët nuk mund ta dinin që tani. Pra, mund t'i lini me kusht.

Z. Misetic keni fjalën.

Z. MISETIC: [Përkthim] Po, faleminderit, i nderuar Gjykatës. Parimisht nuk kemi ndonjë kundërshtim për propozimet e Trupit Gjykues, sidomos për çështjen e kundërpyetjeve dhe vlerësimit kohor, ju falënderojmë që na e lini neve në dorë që të bëjmë një vlerësim që të shikojmë çfarë mund të bëhet me dëshmitarë të ndryshëm.

Gjithashtu do t'ju luteshim që të mbani, që të mendoni edhe që të ketë pakësim të pyetjeve nga pala thirrëse.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë e përmendëm.

Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e dija që urdhri mbulonte edhe këtë. Dhe mbase me ca kursime të kohës, disa kursime kohore mund të bëhen edhe në këtë.

Masat në formë urdhrash duhet të zbatohen për të dyja anët, siç e përmendëm edhe në parashtrimet tona herën që shkoi. Qëndrimi që mban Mbrojtja është se problemi i vërtetë këtu është numri i dëshmitarëve që mbeten ende për t'u thirrur nga ZPS-ja, duke -- kështu që ju u keni dhënë atyre kohë deri, afat deri në 21 maj për të ardhur me disa ide, të propozojë disa ide për ta ulur këtë numër. Kjo duket, por ne mendojmë se nuk duhet të jetë e njëanshme, pra, t'i lihet në dorë vetëm ZPS-së. Çdo vonesë në këtë gjykim do të çonte në periudha pritjeje. Ja, neve na duhet të presim deri më datë, deri në 21 maj apo çfarëdolloj date kur mendon Prokuroria se na drejtohet neve që të kuptojmë më qartë se cili është numri i dëshmitarëve që do të sjellë ZPS-ja. Qëllimi është që të çohet përpara ky proces; të përshpejtohet dhe të përfundojë brenda prillit 2025.

Këto janë parashtrimet tona.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Emmerson.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Kemi bërë një kërkesë që në të ardhmen të bëhet një regjistrim i orëve sa i takon pyetjeve që po përdor Mbrojtja. Pra, duhet që të bëhet zbërthimi midis pyetjeve që vijnë nga kundërpyetjet dhe pyetjet që vijnë

medoemos nga pyetjet plotësuese në mënyrë që të dimë se sa pyetje janë kundërpyetje dhe sa prej tyre vijnë nga gjëra që dalin në sallën e gjyqit. Këto duhen mbajtur parasysh.

Po e përpilojmë zyrtarisht këtë kërkesë.

Ka një koment shtesë për këtë. Nuk është se kam ndonjë gjë, pra, më falni, përveç këtij komenti nuk kam asgjë tjetër shtesë për të thënë ndaj asaj që ka thënë z. Misetic.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni parasysh që kur pamë këto vlerësimet e kundërpyetjeve, mua m'u duk sikur e thashë qartë, por mbase edhe s'kam qenë i qartë që kemi bërë edhe ne propozimet për të shkurtuar kohën e Prokurorisë, sidomos në rastet e dëshmitarëve sipas rregullës 154.

Dhe së dyti, nuk e shohim se po ua ulim kohën ekipeve individuale, të veçanta, por një shkurtim kohe për të gjithë ju së bashku dhe pastaj ju mes njëri-tjetrit mund të bini dakord si do përdoret koha.

Në rregull.

Z. Tully mund të flisni.

Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë kundërshtim për urdhrin parimisht dhe mbështesim parashtrimet e kolegëve. Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë kundërshtim në parim

për të rishikuar çmuarjet kohore, por ka disa prej dëshmitarëve që i nderuari Gjykatës i renditi që do të jenë padyshim dëshmitarë të rëndësishëm, por mund të shikojmë edhe një herë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këta i nxora, këta i përzgjodha për të përmendur enkas, sepse këto janë ato me ndikimin më të madh dhe mund të fitojmë diçka aty.

Z. ELLIS: [Përkthim] Mund ta shikojmë edhe një herë vlerësimin që i kemi bërë ne kohës mes tyre mbase mund të ketë nga ato që kanë nevojë për më shumë kohë; disa nuk kanë nevojë për më shumë kohë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk duam që të dukemi sikur po i biem në qafë kohës në këtë rast, por sigurisht. Unë e di që ju keni bërë përpjekje që të jeni efikas në kundërpyetjet tuaja dhe ju falënderojmë për këtë.

Do ta mendojmë këtë propozim dhe do të nxjerrim një urdhër sidomos sa i takon afateve për të marrë përgjigjet.

Nëse ka çështje të tjera për të ngritur, përndryshe sot, për sot kemi mbaruar.

Nëse nuk ka, në rregull atëherë. Faleminderit shumë për bashkëpunimin.

--- Seanca mbyllet në orën 14.47